



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më.27 janar 2012
Nr. ref.: RK192 /12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 06/11

Parashtruesi

Prof. dr. Shaban Hasi

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Senatit të
Universitetit të Prishtinës, ref. nr 4/449, të datës 03.12.2010**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Prof. dr. Shaban Hasi, nga Gllgovci, me banim në Gllgovc, Rr. e “Jasharajve” p.n.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Njoftimi i Senatit të Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: UP), ref. nr. 4/449, i datës 03.12.2010.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 21.11.2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit ref. nr. 4/449, të datës 03.12.2010, i nënshkruar nga Rektori i UP-së, z. Mujë Rugova, me anë të të cilit Fakulteti i Mjekësisë (shërbimi financiar), zyrtari ligjor i UP-së, Zyra akademike dhe profesorët z. Shaban Hasi e z. Lutfi Dervishi njoftohen se **çështja e zgjedhjes së këtyre dy profesorëve refuzohet** sepse të përmendurit janë në procedurë gjyqësore dhe njëkohësisht obligohet shërbimi financiar i UP-së që të përmendurit t'i largojë nga lista e pagave.

Baza ligjore

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 21.01.2011, prof. dr. Shaban Hasi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës me të cilën kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: UP) ref. nr. 4/449, të datës 03.12.2010.
6. Më 14 shkurt 2011, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović e Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë.
7. Më 03 mars 2011, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe Universitetin e Prishtinës lidhur me regjistrimin e kërkesës së parashtruar në këtë Gjykatë, duke kërkuar nga UP përgjigje me shkrim lidhur me kërkesën dhe komentet eventuale.
8. Në aftin ligjor prej 45 ditësh Gjykata nuk mori asnjë përgjigje nga UP.
9. Më 9 qershor 2011, pas raportimit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović e Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë, i rekomandoi përbërjes së plotë të Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Prof. Shaban Hasi, sipas pohimit të tij në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka punuar në Fakultetin e Mjekësisë që nga viti 1987.

11. Universiteti i Prishtinës, më datë të papërcaktuar të muajit dhjetor 2010, kishte dërguar Njoftimin Ref. nr 4/449 në Fakultetin e Mjekësisë dhe një kopje të tij edhe: arkivit të UP-së, zyrës për çështje akademike, fakultetit, zyrtarit ligjor të UP-së, të përmendurve (prof. dr. Shaban Hasit dhe prof. Lutfi Dervishit) dhe shërbimit financiar të UP-së, të cilin e kishin nënshkruar Rektori i UP-së, prof. dr. Mujë Rugova dhe zyrtari ligjor i UP-së, në të cilin njoftim ishte theksuar se UP në mbledhjen e Senatit të mbajtur më 8.11.2010 kishte vendosur që, "çështja e zgjedhjes së prof. Shaban Hasit dhe prof. Lutfi Dervishit të refuzohet për shkak se të përmendurit janë në procedurë gjyqësore".
12. Përmes këtij njoftimi gjithashtu është obliguar shërbimi financiar i UP-së që të përmendurit t'i heqë nga lista e pagave nga data e mbajtjes së mbledhjes së Senatit (8.11.2010).
13. Nëpërmjet avokatit Shaqir Behrami, prof. dr. Shaban Hasi është ankuar në Senatin e UP-së për shkak të ndërprerjes së njëanshme të kontratës në Fakultetin e Mjekësisë, dhe atë pa vendim të Senatit, me propozimin që Senati të marrë vendim për ANULIMIN e Njoftimit ref. 4/449 dhe që t'i vazhdohet marrëdhënia e punës në pozitën që kishte para këtij njoftimi.
14. Lidhur me këtë ankesë, prof. Shaban Hasi nuk mori asnjë përgjigje nga Senati i UP-së.
15. Më 07 dhjetor 2010, sipas kërkesës së prof. dr. Shaban Hasi, Gjykata Komunale në Glllogovc ka lëshuar një certifikatë me të cilën vërtetohet se ndaj z. Shaban Hasi nuk është ushtruar aktakuzë e plotfuqishme e as nuk është gjykuar me aktgjykim për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3(tre) vjetësh, ose dënimi me gjobë.
16. Më 14.12.2010, Fakulteti i Mjekësisë me shkresën ref. nr. 4333, të nënshkruar nga Dekani i fakultetit, i ka dërguar përgjigje në kërkesën e tij në të cilën ka konfirmuar se ky fakultet nuk ka të dhëna se prof. Shaban Hasi është dënuar ndonjë herë apo që në të kaluarën e deri më sot të ketë marrë ndonjë vërejtje në punën e tij nga dekanati i këtij fakulteti.
17. Më 20.12.2010, dekanati i Fakultetit të Mjekësisë me shkresën zyrtare ref. nr. 4421 i ka dërguar prof. Shaban Hasit një tjetër përgjigje, me të cilën konfirmohet se Rektori i UP-së nuk ka kërkuar ndonjë sqarim apo informatë me shkrim nga Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë lidhur çështjen e ngritur ndaj tij (procedura eventuale gjyqësore), dhe se Dekani i Fakultetit të Mjekësisë nuk është në dijeni për këtë çështje.
18. Përfundimisht, më 21.01.2011 prof. dr. Shaban Hasi parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të cekura në kërkesë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se konsideron që me njoftimin të cilin e sfidon para Gjykatës atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë për jetë dhe punë.
20. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në Gjykatën Kushtetuese ka theksuar se me Njoftimin ref. nr. 4/449, të nënshkruar nga Rektori i UP-së, i cili nuk e ka as formën e vendimit, atij në mënyrë të kundërligjshme i është mohuar e drejta për të ushtruar detyrën e profesorit të lëndës së Kirurgjisë në Fakultetin e Mjekësisë, nga shkak se gjoja ai gjendet në procedurë gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai asnjëherë nuk ka qenë në procedurë gjyqësore, dhe se për këtë posedon edhe dokumentacionin

përkatës që ia vërteton këto pohime. Njoftimin e Rektorit e quan arbitrar dhe pretendon se me këtë akt i janë shkelur të drejtat kushtetuese për punë dhe jetë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Gjykata gjithashtu merr parasysh: nenin 46 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës që i referohet kërkesave individuale dhe në të cilin përcaktohet:

"Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore."

23. Duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në kërkesë, Gjykata konstaton se parashtruesi i saj nuk ka përmbushur kushtin e shterjes së mjeteve të parapara juridike, sepse nuk ka ofruar dëshmi që përpos një ankese në Senatin e UP-së të ketë ushtruar ndonjë mjet tjetër juridik apo të ketë marrë ndonjë vendim merititor nga ndonjë organ administrativ, apo gjykatë e rregullt, para se t'i drejtohej me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
24. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se kriteri juridik i shterjes së "të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj" është absolutisht i domosdoshëm si kusht esencial për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe përpos që është një kusht juridik i paraparë me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, si kusht esencial juridik parashihet edhe me rregullin 36 par.(a) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.
25. Gjithnjë duke iu referuar këtij kriteri të pranueshmërisë, Gjykata vë në pah se me Ligjin nr. 2002/03 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, të shpallur më 12 maj 2003 nga Michael Steiner, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm, përkatësisht me nenin 25.5, është qartë e përcaktuar se:

" Personeli akademik e joakademik i bartësit të arsimit të lartë gëzon të drejtën për të apeluar ndaj një vendimi apo veprimi të institucionit të arsimit të lartë lidhur me to te Ministria dhe pastaj tek një gjykatë e juridiksionit kompetent."

26. Nga sa u tha në paragrafët e mësipërme, është e qartë se këtë mundësi ligjore për përdorimin e këtij mjeti juridik parashtruesi i kërkesës nuk e ka shfrytëzuar.
27. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të

drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. Francë nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).

28. Një arsyetim të tillë Gjykata e kishte aplikuar gjatë shqyrtimit të mëparshëm të kërkesave në rastet: KI 55/10 - Hamide Osaj në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 43/2010, të datës 4 qershor 2010; Rastin nr. KI 20/10 - Muhamet Bucaliu kundër Vendimit të Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. 09/10, të 24 shkurtit 2010 (vendimi i GJ. Kushtetuese i datës 15 tetor 2010).
29. Në këto rrethana, kërkesa është e papranueshme sepse parashtruesi i saj nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1(a) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 14 qershorit 2011, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- I. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20-4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani